

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, 2023-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Ky projekakt është hartuar në zbatim të urdhrit nr. 76, **datë 22.04.2022** të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe Plani i Veprimit, 2023-2030”.

Janë zhvilluar këto takime:

Data	Takimet e organizuara
25 Mars 2022	Mbledhja e Grupit Tematik të Decentralizimit për hartimin e strategjisë së Re të Decentralizimit, me pjesëmarrjen e partnerëve të zhvillimit dhe donatorëve, të cilët do të mbështesin me ekspertë dhe ekspertizë.
21 Prill 2022	Miratim i vizionit, konceptit dhe afateve kohore të SNDQV 2023-2030 nga Komiteti i Planifikimit Strategjik.
12-13 Qershor 2022	Takim konsultativ me SIGMA-OECD mbi metodologjinë e hartimit të SNDQV-së 2023-2030.
17 Qershor 2022	Konferenca hapëse mbi hartimin e Strategjisë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit.
29 Qershor 2022	Takim me kryetarët e bashkive të qarkut Elbasan dhe Shoqatën për Autonomi Vendore.
28-29 Gusht 2022	Seminar mbi rekomandimet e disa funksioneve specifike të njësisve të vetëqeverisjes vendore.
23 Shtator 2022	Takim konsultativ për hartimin e Strategjisë me stafet teknike të bashkive dhe të këshillave bashkiake.
29 Shtator 2022	Takim me Grupin Politik të Punës mbi hartimin e SNDQV-së dhe Planit të Veprimit.

Konsultimi publik në RENJK për periudhën kohore, nga data 07 dhjetor 2022 deri më datë 29 dhjetor 2022. Si përfundim, kohëzgjatja e konsultimit në tërësi ka qenë nga data 25 mars 2022 deri në dhjetor 2022.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për **Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, 2023-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”** ishin tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK
2. Takime të grupit të punës;
3. Email.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Koordinatori për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
<i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të</i>	<i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>		

	<i>interesuara së bashku)</i>			